



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 525/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Fjala, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit të votave në formularin e të dhënave dhe rezultateve të (KQZ), për shkak të parregullsive në qendrën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 18.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa lejuara ankesat Anr.525/2021 e datës 16.02.2021, e subjekti politik Fjala, me të cilën ka kërkuar që të Urdhërohet KQZ-ja, të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në Komunën e Skenderajt dhe në gjitha komunat tjera në Kosovë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021.

A r s y e t i m

Me datë 16.02.2021, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.525/2021, e paraqitur nga subjekti politike Fjala, e paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilën pretendon se në vendvotimin 2129B/01D në komunën e Skenderajt nuk i janë regjistruar votat në formularin e të dhënave dhe rezultateve të KQZ, e që sipas tyre në atë vendvotim subjekti politik Fjala ka 24 vota e ndërsa në KQZ, janë 0 (zero) vota. Më tutje kërkojnë nga PZAP që të trajtojnë këtë parregullsi jo vetëm në këtë vendvotim por në të gjitha vendvotimet e tjera në Kosovë.

Paneli, në kuptim të nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it e informoi KQZ lidhur me ankesat e paraqitura ndaj tyre, nga subjekti politik Fjala, duke kërkuar që të përgjigjen ndaj ankesës deri më datë 16.02.2021 në ora 15:00.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduara në ankesë përkitazi me parregullsitë në qendrat e votimit në komunat e Skenderajt, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e

shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së subjektit politik Fjala, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: “*ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, i hudhë si të pa lejueshme*” ankesa është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 525/2021 më datën 18.02.2021

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

